



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22.02.2025

Nr: 135

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 39 ID, DATË 19.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË
KOMITETIT SHQIPTAR I HELSINKIT**

Sot më datë 22.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Komitetit Shqiptar i Helsinkit

SUBJEKT: **Z. Gledian Llatja**
Kryetar për Bashkinë Elbasan

OBJEKT: Sinjalizim për dy veprimtari publike të ndaluara në Bashkinë Elbasan

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Komitetit Shqiptar i Helsinkit më datë 19.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 39 ID.

Në këtë denoncim Komiteti Shqiptar i Helsinkit parashtroi sa vijon:

“Në Bashkinë Elbasan është evidentuar se Zyra Elektorale e Partisë Socialiste në këtë Bashki, është zhvendosur në një ambient në të cilin më parë kanë qenë zyrat e ZRVPP Elbasan, një institucion publik në varësi të pushtetit qendror. Vazhdon aktualisht përdorimi i këtij ambienti si Zyrë Elektorale e PS. Deri para pak muajsh kjo Zyrë ishte vendosur në një ambient privat.

Data: 22.02.2025

Nr: 135
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 39 ID datë 19.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Komitetit Shqiptar i Helsinkit”

Në datën 15 Janar në mesin e ish-kinema 'Vullnetari' me adresë në Elbasan, Qendra Rinore, pranë Universitetit Aleksandër Xhuvani, Godina Kryesore, që është në administrim të Bashkisë Elbasan, është mbajtur një takim elektoral. Kjo evidentohet nëpërmjet postimeve të datës 15 Janar në rrjetet sociale të Kryetarit të Bashkisë dhe të figurave të Partisë Socialiste.”

Nga sa më sipër çmohet se, ekzistojnë kushtet për t'u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Z. Gledian Llatja, Kryetar për Bashkinë Elbasan.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI